

VENDIM
Nr.106, datë 4.9.2008

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E “KONTRATËS PËR
FURNIZIMIN ME ENERGJI ELEKTRIKE NDËRMJET SHOQËRISË KESH SHA
(FURNIZUESI PUBLIK ME SHUMICË) DHE SHOQËRISË OSSH SHA (FURNIZUESIT
PUBLIK ME PAKICË) PËR PERIUDHËN 1.7.2008 DERI MË 31.12.2008**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës 7 germa “f”, paragrafi 5, të modelit të tregut të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.338, datë 19.3.2008, pikës V.1, të rregullave të tregut të energjisë elektrike, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.68, datë 23.6.2008, nenit 18, pika 1, germa “c”, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE nr.44, datë 24.7.2007, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.9.2008, pasi diskutoi mbi draftin e kontratës “Për furnizimin me energji elektrike ndërmjet shoqërisë KESH sh.a. (Furnizuesi publik me shumicë) dhe shoqërisë OSSH sh.a. (Furnizuesit publik me pakicë) për periudhën 1.7.2008 deri me 31.12.2008”,

konstatoi se:

- kontrata është lidhur nga KESH sh.a. dhe OSSH sh.a. subjekte të licencuara nga ERE, përkatësisht me vendimet nr.9, datë 25.1.2008 dhe nr.11, datë 23.6.2006, të ndryshuar;
 - modeli i tregut të energjisë elektrike dhe Rregullat e tregut shqiptar të energjisë elektrike përcaktojnë se kjo kontratë i nënshtrohet tregut të rregulluar;
 - në referencë të akteve të sipërcituara, ERE është autoriteti i përcaktuar për miratimin e kësaj kontrate,
- për sa më sipër evidentuar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për miratimin e kontratës “Për furnizimin me energji elektrike ndërmjet shoqërisë KESH sh.a. (furnizuesi publik me shumicë) dhe shoqërisë OSSH sh.a. (furnizuesit publik me pakicë) për periudhën 1.7.2008 deri më 31.12.2008.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit ta njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s dhe ndjekjen e mëtejshme të procedurave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepavishta